2559/21
05.11.26

AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Nr. 954/1 prot.

Tiranë, më 5.11.2026

Lënda: Komente për projekt-metodologjinë "Metodologjia e përcaktimit të vlerave referuese në rastet kur të dhënat e matjes së energjisë elektrike janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme" dhe për projekt-rregulloren "Për mënyrën e funksionimit të mjetit online të krahasimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike" të Entit Rregullator të Energjisë

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë

Me anë të shkresave nr. 2559/11 prot., datë 21.10.2026, dhe nr. 2559/12 prot., datë 21.10.2026, protokolluar pranë Avokatit të Popullit, respektivisht, me nr. 954 prot., datë 26.10.2026, dhe nr. 953 prot., datë 23.10.2026, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka përcjellë, respektivisht, ftesën për konsultim dhe paraqitje komentesh për projektmetodologjinë "Metodologjia e përcaktimit të vlerave referuese në rastet kur të dhënat e matjes së energjisë elektrike janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme" (Vendimi nr. 287, datë 08.10.2026), si dhe për projekt-rregulloren "Për mënyrën e funksionimit të mjetit online të krahasimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike" (Vendimi nr. 288, datë 08.10.2026). Të dy projektaktet janë hartuar nga ERE në zbatim të ligjit nr. 59/2026, datë 18.06.2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

Në vijim, po ju paraqesim komentet e institucionit të Avokatit të Popullit për të dy projektaktet, në këndvështrimin e mandatit të tij për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të parimit të administrimit të mirë, me fokus të drejtat e klientëve fundorë si konsumatorë të shërbimit të furnizimit me energji elektrike. Komentet paraqiten të ndara për secilin akt.

I. Lidhur me projektmetodologjinë "Metodologjia e përcaktimit të vlerave referuese në rastet kur të dhënat e matjes së energjisë elektrike janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme"

Vlerësojmë pozitivisht që projektmetodologjia përcakton karakterin e përkohshëm të faturimit me vlerë referuese dhe kufirin prej 3 (tre) muajsh (nenet 3 dhe 13), vlerën referuese 0 kWh për klientët pa asnjë të dhënë faktike të matjes (neni 6), pasqyrimin e korrigjimit në faturë (neni 8, pika 5), si dhe

gjurmueshmërinë e metodës së përdorur (nenet 9 dhe 10). Me qëllim që këto garanci të jenë efektive për klientin, paraqesim komentet e mëposhtme.

- Në nenin 2, pika 1, parashikohet që "Kjo metodologji zbatohet nga furnizuesit e energjisë elektrike për klientët për të cilët të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme".

Sipas nenit 92, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, "operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE-ja". Edhe Vendimi nr. 287, datë 08.10.2026, parashikon që operatori i rrjetit llogarit vlerën referuese, ndërsa furnizuesi e përdor atë për qëllime faturimi. Rekomandojmë që në nenet 2 dhe 3 të parashikohet shprehimisht se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) llogarit vlerën referuese, mbi bazën e të dhënave të matjes që administron sipas nenit 92, pika 1, të ligjit, dhe ia përcjell atë furnizuesit për faturim.

- Në nenin 2, pika 2, parashikohet që të dhënat e matjes konsiderohen të padisponueshme kur "Furnizuesi merr dijeni nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes", ndërsa në nenin 9, pika 2, parashikohet që metoda e përdorur "dokumentohet në sistemin e faturimit".

Rekomandojmë që, në përputhje me nenin 7 të projekt-rregullores "Për kërkesat minimale në përmbajtjen e faturave të energjisë elektrike dhe informacionin e faturimit", fatura me vlerë referuese të përmbajë një informacion të qartë për klientin lidhur me faktin se faturimi është kryer mbi bazën e një vlere referuese si dhe shkakun e mungesës së të dhënave, datën e fillimit, metodën e përdorur, sasinë në kWh, afatin maksimal të aplikimit, mundësinë e klientit për të dërguar vetëlexim dhe të drejtën e ankimit pranë furnizuesit dhe ERE-s, në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 59/2026.

- Në nenin 5, pika 1, parashikohet që vlera referuese përcaktohet mbi bazën e konsumit "të matur dhe të regjistruar në sistemin e faturimit gjatë 12 (dymbëdhjetë) muajve të fundit".

Në rastet kur klienti ka ndryshuar furnizues, furnizuesi i ri mund të mos disponojë historikun e faturimit. Rekomandojmë që të dhënat historike të merren nga OSSH-ja, si subjekti përgjegjës për matjen sipas nenit 92, pika 1, të ligjit nr. 59/2026, si dhe të përcaktohet cili furnizues kryen korrigjimin dhe sipas çmimit të cilës kontratë, kur periudha e faturimit me vlerë referuese përfshin dy furnizues.

- Në nenin 7, pikat 1 dhe 2, parashikohet që për matësit e instaluar në boks kolektiv "nuk zbatohet faturimi me vlerë referuese për shkak të mungesës së aksesit në të dhënat e matjes" dhe se "Furnizuesi dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes marrin masat për sigurimin e të dhënave faktike të matjes".

Ka raste kur klienti has vështirësi në identifikimin e matësit që i përket kontratës së tij. Sipas nenit 92, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, operatorët duhet të sigurojnë që të gjithë klientët fundorë "të jenë në gjendje të lexojnë me lehtësi matësat e tyre konvencionalë". Rekomandojmë që të përcaktohen:

- afati për OSSH-në për sigurimin e aksesit dhe të leximit;
- detyrimi për identifikimin e matësit për çdo kontratë dhe për njoftimin e klientit;

- mënyra e faturimit dhe e shlyerjes së konsumit të grumbulluar, pas marrjes së të dhënave faktike.

- Në nenin 8, pika 1, parashikohet që "Kur, pas faturimit me vlerë referuese, bëhen të disponueshme të dhënat faktike të matjes, Furnizuesi kryen korrigjimin e faturimit në përputhje me konsumin faktik të regjistruar".

Korrigjimi mbështetet në të dhënat faktike që bëhen të disponueshme më pas. Kur OSSH-ja konstaton se matësi ka qenë jashtë kushteve teknike të funksionimit, konsumi i periudhës së kaluar nuk është matur saktë dhe nuk mund të matet më. Nga ankesat e trajtuara nga Avokati i Popullit rezultojnë raste kur klienti nuk ka pasur mundësi të provojë konsumin e periudhës me matje të pasaktë, për shkak se nuk banonte në banesë. Ndërkohë, nenet 4 dhe 5 marrin si bazë "të dhënat faktike të matjes", pa përjashtuar periudhat kur matësi është konstatuar më pas jashtë kushteve teknike të funksionimit. Rekomandojmë:

- si bazë për përcaktimin e vlerës referuese sipas neneve 4 dhe 5 të merren vetëm të dhënat e matësve brenda kushteve teknike të funksionimit;
- të sqarohet marrëdhënia me nenin 93, pika 7, të ligjit nr. 59/2026, sipas të cilit, kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës, përllogaritjet e energjisë së faturuar më shumë ose më pak bëhen sipas rregullave dhe procedurave të kodit të rrjetit, në mënyrë që klienti të dijë cilat rregulla zbatohen për periudhën me matje të pasaktë dhe të ketë akses në aktin e verifikimit të matësit;
- klienti të ketë të drejtë të paraqesë prova se konsumi i tij ndryshon nga vlera referuese, si në rastin e banesës që nuk banohet për një periudhë të gjatë.

II. Lidhur me projekt-rregulloren "Për mënyrën e funksionimit të mjetit online të krahasimit të ofertave të furnizimit me energji elektrike"

Vlerësojmë pozitivisht që projekt-rregullorja garanton aksesin pa pagesë në platformë dhe pa detyrim identifikimi (neni 7), trajtimin e barabartë të furnizuesve dhe publikimin e informacionit mbi administrimin dhe financimin e platformës (neni 6), aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara (neni 19), kufizimin e të dhënave të kërkuara nga përdoruesi në ato rreptësisht të nevojshme (nenet 7 dhe 8), mbrojtjen e kontratave të lidhura më parë nga korrigjimi i informacionit të ofertës (neni 2, pika 4), si dhe raportimin publik çdo 6 (gjashtë) muaj mbi funksionimin e platformës (neni 29). Me qëllim që këto garanci të jenë efektive për klientin, paraqesim komentet e mëposhtme.

- Në nenin 6, pika 1, shkronja ë), parashikohet që platforma përmban "mekanizmin për raportimin e informacionit të pasaktë", ndërsa në nenin 2, pika 4, parashikohet që furnizuesit korrigjojnë ose përditësojnë informacionin "pa vonesë dhe, në çdo rast, brenda 72 (shtatëdhjetë e dy) orëve nga momenti kur konstatohet se ai është i pasaktë, i paplotë ose ka ndryshuar".

Neni 100, pika 2, shkronja e), i ligjit nr. 59/2026 kërkon që mjeti i krahasimit "të sigurojë një procedurë efektive për raportimin e informacionit të pasaktë për ofertat e publikuara". Rekomandojmë që projekt-rregullorja të përcaktojë:

- subjektet që mund të raportojnë informacion të pasaktë;
- afatin brenda të cilit ERE e shqyrton raportimin dhe ia përcjell furnizuesit;
- momentin nga i cili fillon afati prej 72 orësh për korrigjimin;
- njoftimin e përdoruesit që ka raportuar për rezultatin e shqyrtimit;
- pasojën kur furnizuesi nuk e korrigjon informacionin brenda afatit.

- Në nenin 9, pika 3, parashikohet që "Në paraqitjen standarde, ofertat renditen sipas çmimit për njësi, në rend rritës".

Sipas nenit 9, pika 2, lista e ofertave paraqitet pa përfshirë çmimin dhe shpenzimin vjetor të vlerësuar. Ndërkohë, çmimi për njësi nuk pasqyron komponentët fiks të çmimit, kostot e tjera të aplikueshme dhe zbritjet (neni 11, pika 3), të cilat ndryshojnë nga një ofertë në tjetrën dhe merren parasysh në përllogaritjen e shpenzimit vjetor të vlerësuar sipas neneve 13 dhe 14. Për rrjedhojë, renditja standarde mund të mos i japë klientit një pasqyrë të qartë se cila ofertë paraqet koston më të ulët për të.

Neni 100, pika 1, i ligjit nr. 59/2026 kërkon që mjeti i krahasimit t'i krahasojë ofertat "sipas kritereve të qarta dhe objektive për informimin e konsumatorëve". Rekomandojmë që lista e ofertave të përmbajë, për secilën ofertë, çmimin për njësi dhe shpenzimin vjetor të vlerësuar, dhe që në paraqitjen standarde ofertat të renditen sipas shpenzimit vjetor të vlerësuar.

II. Përfundime

Avokati i Popullit vlerëson se të dy projektaktet përmbajnë garanci të reja për mbrojtjen e klientëve fundorë. Me qëllim që këto garanci të jenë të zbatueshme dhe efektive, ju lutemi të merrni në konsideratë komentet dhe rekomandimet e mësipërme gjatë miratimit përfundimtar të akteve.

Mbetemi të gatshëm për çdo bashkëpunim të mëtejshëm në kuadër të procesit të konsultimit.

AVOKATI I POPULLIT

Endrit Shabani

Autorizuar me Urdhër

DREJTORI I KABINETIT

Petrit Bushi